



BASHKIMI EVROPIAN

**ZYRA E BASHKIMIT EVROPIAN NË KOSOVË /
PËRFAQËSUESI SPECIALE I BASHKIMIT EVROPIAN**

NJOFTIM PËR SHTYP

VEPRO TANI - Në Kosovë lansohet projekt i ri i financuar nga BE-ja për t'i rritur kapacitetet e shoqërisë civile në mbështetje të reformës së administratës publike dhe përmirësimit të sundimit të ligjit

PRISHTINË, 6 qershor 2023 - Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë e ka lansuar projektin e ri "Përkrahja e Reformës së Administratës Publike dhe Sundimit të Ligjit përmes Luftimit të Korrupsionit dhe Përmirësimit të Ofrimit të Shërbimeve – VEPRO TANI

Përgjegjës për zbatimin e projektit, për të cilin është ndarë një buxhet total prej afro 200,000 eurosh dhe i cili pritet të zgjasë për afro 3 vjet, do të jetë Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS).

VEPRO TANI synon ta avancojë drejtpërsëdrejti luftën kundër korrupsionit dhe ofrimin e përgjithshme të drejtësisë përmes monitorimit sistematik të sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial në Kosovë, si dhe përmes ofrimin të analizave, rekomandimeve dhe ekspertizave ligjore të ndryshme për institucionet kryesore. Përveç kësaj, do të bëhet edhe monitorimi i drejtpërdrejtë i Agjencisë kundër Korrupsionit dhe Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar. Në kuadër të këtij komponenti të parë, VEPRO TANI do ta prezantojë një platformë të monitorimit që do ta mbulojë tërë spektrin e çështjeve që e kanë pllakosur sistemin gjyqësor dhe atë prokurorial në Kosovë.

Krahas kësaj, ky projekt synon ta përshpejtojë reformën e administratës publike përmes mbështetjes së drejtpërdrejtë për thjeshtimin e procedurave dhe zbatimin e Programit për Parandalimin dhe Reduktimin e Barrës Administrative (2022-2027) dhe planit të tij të veprimit, që janë miratuar së fundmi. Do të zhvillohen rregullisht fushata për avokim dhe informim, për t'i informuar qytetarët dhe bizneset për të drejtat e tyre për të kërkuar dëmshpërbim në rastet e shkeljeve administrative.

Projekti i mbulon të dy këta sektorë të ndërlidhur, meqë probleme të ngjashme (korrupsioni, keqpërdorimet, procedurat tejet burokratike, rekrutimet jomeritore, mungesa e efikasitetit dhe kompensimit të dëmeve) e karakterizojnë si sektorin e drejtësisë, ashtu edhe atë të administratës publike shtetërore të mbingarkuar me staf.

Projekti do t'i synojë akterët institucionalë kryesorë të sektorit të drejtësisë dhe administratës publike, siç janë: Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Ministria e Drejtësisë dhe agjencitë përkatëse; Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra e Kryeministrit etj. Duke ndikuar në politikat dhe proceset legislative, VEPRO TANI do të ketë ndikim pozitiv si në ofrimin e drejtësisë, ashtu edhe në efikasitetin e administratës publike, duke çuar në shërbime më të mira për qytetarët.

Për informata më të hollësishme, luteni ta lexoni Buletin e Projektit [këtu](#).